

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universiteti Prizrenia	
"UKSHIN HOTI"	
Pranuar me tit.	01.02.2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-13



**Universiteti  
"Ukshin Hoti"  
Prizren**

**DOKU  
FEST**

**Festivali Ndërkombëtar  
i Filmit Dokumentar dhe  
të Shkurtër "DokuFest"**

**ITP** >

**Parku i Inovacionit  
dhe Trajnimit (ITP)  
Prizren**

## **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR ORGANIZIMIN E SHKOLLËS VERORE NDËRKOMBËTARE**

*NDËRMJET*

**Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren**

**&**

**Festivali Ndërkombëtar i Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër "DokuFest"**

**&**

**Parku i Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) Prizren**

### **Neni 1**

Marrëveshja e Bashkëpunimit (në tekstin e mëtejme Marrëveshje) lidhet mes Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, përfaqësuar nga UD Rektori Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj, DokuFest, përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive Linda Llulla, Innovation and Training Park (ITP) Prizren (e menaxhuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH), përfaqësuar nga Përfaqësuesi i Autorizuar Muhamed Rexhepi.

### **Neni 2**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit është bashkëpunimi në mes të tre (3) palëve për organizimin e Shkollës Verore Ndërkombëtare në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren.

### **Neni 3**

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizrenit, DokuFest dhe ITP Prizren pajtohen që për interesa të përbashkëta të asistojnë, promovojnë, përkrahin dhe ngrisin bashkëpunimin reciprok në mes të palëve, në funksion të organizimit të Shkollës Verore Ndërkombëtare.

### **Neni 4**

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizrenit, DokuFest dhe ITP Prizren së bashku do të kontribuojnë në organizimin dhe mbarëvajtjen e Shkollës Verore Ndërkombëtare, duke përfshirë aktivitetet e përbashkëta si në vijim:

1. Kurset/modulet e Shkollës Verore Ndërkombëtare;
2. Aktivitetet jashtëkurrikulare;
3. Aktivitet artistike, kulturore dhe sportive;

4. Tryezat e rumbullakëta;
5. Punëtoritë tematike;
6. Seminaret profesionale;
7. Ligjerata të hapura me personalitete të ftuara;
8. Promovimin e përbashkët të Shkollës Verore Ndërkombëtare; dhe
9. Aktivitete të tjera sipas interesit të përbashkët.

#### **Neni 5**

Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren, DokuFest dhe ITP Prizren pajtohen për aplikimin e përbashkët në përgatitjen e propozimeve për projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me mbështetjen dhe mbarëvajtjen e Shkollës Verore Ndërkombëtare.

#### **Neni 6**

DokuFest do të pranojë një numër të studentëve të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren për të kryer praktikën profesionale në hapësirat e DokuFest-it gjatë periudhës së festivalit.

#### **Neni 7**

ITP Prizren pajtohet që të ofroj akomodimin e një numri të studentëve (deri në 60 studentë) në konviktet brenda ITP Prizren, për nevojat e Shkollës Verore Ndërkombëtare.

#### **Neni 8**

Universiteti “Ukshin Hoti”, DokuFest dhe ITP Prizren pajtohen që për nevojat e Shkollës Verore Ndërkombëtare të shkëmbejnë ekspertë dhe përvojat e tyre në fushat e caktuara.

#### **Neni 9**

Universiteti “Ukshin Hoti”, DokuFest dhe ITP Prizren pajtohen për shfrytëzimin e infrastrukturës, sallave për mësim, amfiteatrove, etj. për nevojat e Shkollës Verore Ndërkombëtare.

#### **Neni 10**

Marrëveshja e bashkëpunimit ka afat vlefshmërie për periudhën pesë (5) vjeçare, me mundësi të vazhdimit, plotësimit apo ndryshimit me pajtimin e përbashkët të palëve.

#### **Neni 11**

Marrëveshja e bashkëpunimit është e nënshkruar në tre (3) kopje në gjuhën shqipe dhe dy kopje në gjuhën angleze. Në rast të mospërputhjes, vlen kopja në gjuhën shqipe.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

#### **Palët nënshkruese të përfaqësuar nga:**

**Universiteti “Ukshin Hoti”  
Prizren**

**Festivali Ndërkombëtar  
i Filmit Dokumentar dhe  
të Shkurtër “DokuFest”**

**Parku i Inovacionit  
dhe Trajnimit (ITP)  
Prizren**

**Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj**

**Linda Llula**

**Muhamed Rexhepi**

Prizren, 1 Shkurt 2022